



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1285/ Prot.
12

Tiranë, më 13.09. 2022

V E N D I M

Nr. 68 datë 13.09. 2022

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË OBJEKTEVE SPORTIVE,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS.**

Në zbatim të pikës 1/d, të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH", neni 20 i Statutit të UST, neni 7 i Rregullores UST, Senati në mbledhjen e tij të datës 13.09.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren për Ambjentet Sportive, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron Kasa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr 1285/Prot.
2

Tiranë, më 13 . 09 2022

**RREGULLORE E BRENDSHME
PËR FUNKSIONIMIN E FUSHAVE & AMBIENTEVE SPORTIVE NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

**Kjo Rregullore u miratua nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës,
me Vendim nr. 68 , datë 13.09.2022**

TIRANË, SHTATOR 2022

Hyrje

Ambientet Sportive (Palestrat, Fushat e tenisit, futbollit kalçeto, sallat e dancit sportiv etj) (më poshtë do të quhen AS) janë mjedise arsimore sportive nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (më poshtë UST). Këto ambiente shërbejnë për realizimin me efektshmëri të programit akademik mësimor të lojrave sportive si, volejboli, basketboli, hendboli, tenisi, futboli, disiplinat e gjimnastikës, dansi sportiv, koreografia etj.

AS të UST-së, menaxhohen dhe mirëmbahen nga një personel i caktuar i administratës së UST-së, të cilët janë përgjegjës për drejtfunksionimin e menaxhimit të tyre, si dhe zbatimin e gjithë të drejtave e detyrave të miratuara nga Senati i UST-së.

NENI 1

BAZA LIGJORE

Përpilimi i kësaj rregulloreje mbështetet në Neni 801 e vijues të Kodit Civil, në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në 432 datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, Statutin e UST-së si dhe në Vendimin nr. datë/...../ 2021 të Bordit të Administrimit të UST-së.

NENI 2

QËLLIMI I MIRËADMINISTRIMIT TË AS-VE TË UST-SË

1. Të shërbejnë për realizimin e mësimin dhe edukimin e studentëve para dite e mbasdite, me vlerat argëtuese sportive.
2. Të plotësojnë të gjitha kërkesat e masës së studentëve për shfrytëzimin e të gjitha ambienteve sportive për realizimin e mangësive metodike e teknike të programit mësimor që zhvillohet para dite, sipas orarit mësimor.
3. Të plotësojnë të gjitha kërkesat e masës së pedagogëve për trajtimin special ose të veçantë të studentëve në përvehtësimin e vlerave praktike të programit mësimor.
4. Të realizojnë të gjitha kërkesat që bëhen nga masa e studentëve dhe pedagogëve, në interes të një edukimi dhe argëtimi sportiv mbasdite.
5. Të krijoje të ardhura për UST-në duke kontraktuar në kohe reale sipas një grafiku në plotësimin e të gjitha kërkesave të palëve të treta për shfrytëzimin e ambienteve sportive, në oraret dhe hapësirat e lira sipas një grafiku të përcaktuar.

NENI 3

FREKUENTIMI DHE KUJT I SHËRBEJNË AS-TË

1. Studentëve (procesit mësimor)
2. Studentëve dhe pedagogëve (aktivitet rekreativ ose jashtëshkollor)
3. Të tretëve (në bazë të kërkesave dhe kontratave)

4. Kompanive/ institucioneve të ndryshme dhe shoqatave sportive/ bamirëse etj.
5. Aktivitete të ndryshme (Olimpiada, kampionate, shfaqjet sportive etj)

NENI 4

RREGULLAT QË DUHET TË NDJEKIN FREKUENTUESIT E AS-VE:

1. Në AS do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimi vetëm në prezencën e pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me këpucë atlete ose papuçe për disiplinat e gjimnastikës.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në të gjitha AS-të.
4. Ndalohet rreptësisht përdorimi i ushtrimeve të nxemjes/warm-up, në trajtën e futbollit të vogël në palestra, fushë tenisi, kalçeto.
5. Ndalohet rreptësisht hedhja e mbeturinave, pështytja, si dhe çdo lloj ndotje në të gjitha AS të UST-së.
6. Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
7. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat sportive përkatëse të lojrave me dorë, tenis, futboll, disiplinat e gjimnastikës, danc (vallëzim), të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndërmjetme të mësimi, paradite.
8. Marrëdhëniet ndërmjet Administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale.

NENI 5

PËRBËRJA E AS-VE:

Ambientet Sportive në UST përbëhen:

- Palestra e Gjimnastikës
- Palestra e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik
- Palestra e Sporteve të Rënda
- Palestra e Lojrave Sportive (2 fusha volejboli + 2 fusha basketbolli)
- Fushat e Tenisit (2)
- Fusha e minifutbollit
- Fusha e Futbollit
- Sallat e dancit (vallëzimit) (2)

NENI 6

KONTRATAT ME TË TRETËT

6.1 Kushtet dhe Aplikimi

- Të tretët që dëshirojnë të përdorin Palestrën e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik, Palestrën e Sporteve të Rënda, Sallat e Dansit (vallëzimit) etj. duhet të plotësojnë një kërkesë për rezervimin e tyre me NIPTI-in dhe nr. llogarisë së shoqërisë apo shoqatës sportive etj.

- Të tretët që dëshirojnë të përdorin fushat e volejbollit apo basketbollit në Palestrën e Lojrave Sportive duhet të plotësojnë një kërkesë për rezervimin e fushës (që gjenden në sitin zyrtar të UST-së (www.ust.edu.al) dhe të lidhin kontratë për seancat që ato duan të zhvillojnë në Palestrën e Lojrave Sportive të UST-së.
- Grupet amatore mund ta gjejnë formularin e kërkesës për rezervim fushe në faqen zyrtar të UST-së (www.ust.edu.al) ose mund ta bëjnë këtë pranë zyrës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
- Shoqëritë, shoqatat apo kompanitë duhet të dorëzojnë një kërkesë të firmosur dhe vulosur nga titullari i tyre, bashkëngjitur një fotokopje e vërtetimit të NIPT-it dhe llogarisë bankare.
- Klubet, federatat sportive, të cilat dëshirojnë të stërvisin ekipet e tyre të moshave duhet të konsultohen për numrin e lojtarëve të lejuar.

6.2 Tarifat dhe Oraret

- Fushat do të përdoren falas për studentët e universitetit mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë drejtuar Dekanit të fakultetit, ku do të jenë përcaktuar qartë përveç gjeneraliteteve të studentit/studentëve edhe orari, ditët dhe kohëzgjatja, e cila i përcillet Administratorit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
- Fushat do të përdoren falas për stafin akademik dhe administrativ të universitetit mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë ku do të jenë përcaktuar qartë orari, ditët dhe kohëzgjatja.
- Masa e pagesës për marrjen në shërbim me të tretët të fushave llogaritet sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin në fuqi të Bordit të Administrimit të UST-së.
- Oraret sipas grafikut që kompanitë, shoqatat dhe grupet amatore mund të zhvillojnë seancat e tyre pasi kanë lidhur kontratat në Palestrën e Lojrave Sportive janë si më poshtë:
 - o Dita e hënë deri ditën e premte 17:00 – 23:00
 - o Dita e shtunë dhe dita e dielë 09:00 – 22:00

6.3 Kohëzgjatja e Kontratës

- Kohëzgjatja e kontratave me të tretët përcaktohet në bazë të kërkesës së klientit drejtuar Administratorit të UST-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
- Në rast ndërprerje të kontratës, të tretët duhet të dorëzojnë një kërkesë në protokollin e UST-së me arsyen e ndërprerjes një muaj para saj.

NENI 7

PALESTRA E LOJRAVE SPORTIVE

Palestra e Lojrave Sportive është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmeri të programit akademik mësimor të lojrave sportive me dorë si basketbolli, volejbolli, hendbolli, etj.

Palestra e Lojrave Sportive do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i administratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati i UST-së ndërsa gjatë kryerjes së procesit mësimor është stafi ndihmës mësimor pranë Departamenteve në Fakultete.

7.1 PROCESI MËSIMOR

- Palestra e Lojrave Sportive do të vihet në përdorim të procesit mësimor sipas orarit të përcaktuar akademik.
- Në rast se konstatohen shkelje të orareve të paracaktuara, ato do të raportohen në dekanatet përkatëse.
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mban përgjegjësi për sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
- Staf i ndihmës mësimor mban përgjegjësi për vënien në dispozicion të mjeteve përkatëse për zhvillimin e procesit mësimor sipas orarit përkatës.

7.2 ORARET

1. Palestra e Lojrave Sportive do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 23.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 .
2. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e palestrës.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të zhveshjes.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve për vajza e djem.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të pedagogëve, të studentëve etj.
3. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Mirëmbajtjen e administrimit e bazës didaktike mësimore, si pajisjeve sportive të basketbollit, volejbollit, hendbollit, etj në hapësirat e fushave.
 - Sistemimin e funksionimit e bazës didaktike mësimore lëvizëse, e cila do të shërbejë për realizimin e programit mësimor nga ana e pedagogëve, në fushë dhe klasat metodike të mësimit teorik/didaktik.
 - Mirëmbajtjen teknike profesionale të palestrës, e gatshme në çdo moment për mirëfunksionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.
 - Në palestër do të funksionojë një koordinator metodik e teknik për komunikimin me pedagogët që kanë orë zhvillimi të mësimit dhe orë të veçanta specifike, para dite ose mbasdite.

7.3 ETIKA DHE HYRJA

- Në Palestrën e Lojrave Sportive do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimit vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.
- Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me këpucë atlete.
- Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në palestër.
- Ndalohet rreptësisht përdorimi i ushtrimeve të nxemjes në trajtën e futbollit të vogël në palestër.
- Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e palestrës.
- Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
- Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat sportive përkatëse të lojrave me dorë, të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndërmjetme të mësimit para dite.

7.4 DËMTIMET DHE DEFEKTET

1. Të gjitha llojet e dëmtimeve që do të bëhen nga ana e studentëve, para, gjatë dhe mbas orës së mësimit (si varje në koshin e basketbollit, varje në rrjetën e volejbollit, goditje të rrjetave ndarëse, bërje me gjurmë të mureve të brendshme të sallës, të klasave, etj) do të kenë karakterin e çdëmtimit në formën e riparimit ose të një vlere monetare.
2. Koordinatori Teknik dhe personeli përgjegjës teknik/metodik do të marrë të gjithë masat e duhura për eliminimin e ndonjë defekti që mund të ketë ndodhur gjatë orëve të mësimit dhe atyre të mbasdites.
3. Në ndërrimin e shërbimeve para dite me mbasdite, do të ketë një proces verbal mbi dorëzimin e palestrës, ku do të përfshihen të gjithë elementët e domosdoshëm që përbëjnë një kusht të dëmtimit serioz dhe përgjegjësi, për mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e veprimtarive sportive, për të tretët ose më gjerë.
4. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në palestër, Koordinatori dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij, deri në mos funksionim (pajisjet e basketbollit, te volejbollit, elektromotoret e sistemit të uljes e ngritjes së rrjetave ndarëse etj).
5. Proces verbali do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse, e më tej një relacion info për Administratorin.

NENI 8

PALESTRA E FITNESIT DHE KONDICIONIT FIZIK

Palestra e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmeri të programit akademik mësimor të fitnesit dhe kondicionit fizik.

Palestra do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i administratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati i UST-së dhe gjatë procesit mësimor do të jetë përgjegjës stafi ndihmës mësimor pranë departamenteve dhe për venien në dispozicion të bazës materiale.

8.1 PROCESI MËSIMOR

- **Palestra e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik** do të vihet në përdorim të procesit mësimor sipas orarit të përcaktuar akademik.
- Në rast se konstatohen shkelje të orareve të paracaktuara, ato do të raportohen në dekanatet përkatëse.
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mban përgjegjësi për sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
- Stafi ndihmës mësimor mban përgjegjësi për vënien në dispozicion të mjeteve përkatëse për zhvillimin e procesit mësimor sipas orarit përkatës

8.2 ORARET

1. **Palestra e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik** do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 23.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 .

2. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e palestrës.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të zhveshjes.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve për vajza e djem.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të pedagogëve, të studentëve etj.

3. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:

- Etikën dhe hyrjen, mirëmbajtjen e administrimin e bazës didaktike mësimore, si pajisjeve sportive të basketbollit, volejbollit, hendbollit, etj në hapësirat e fushave.
- Sistemimin e funksionimin e bazës didaktike mësimore lëvizëse e cila do të shërbejë për realizimin e programit mësimor nga ana e pedagogëve.
- Mirëmbajtjen teknike profesionale të palestrës, e gatshme në çdo moment për mirëfunksionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.
- Në Palestrën e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik do të funksionojë një koordinator metodik e teknik për komunikimin me pedagogët që kanë orë zhvillimi të mësimit dhe orë të veçanta specifike, para dite ose mbasdite.

4. Në **Palestrën e Fitnesit dhe Kondicionit Fizik** do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimit vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.

- Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me këpucë atlete ose me papuçe apo çorape të përshtatshme për disiplinat përkatëse.
- Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në palestër.
- Ndalohet rreptësisht përdorimi i ushtrimeve të nxemjes në trajtën e futbollit të vogël në palestër.
- Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e palestrës.
- Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
- Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat sportive përkatëse të lojrave me dorë, të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndermjetme të mësimit para dite.

8.3 DËMTIMET DHE DEFEKTET

1. Të gjitha llojet e dëmtimeve që do të bëhen nga ana e studentëve, para, gjatë dhe mbas orës së mësimit do të kenë karakterin e çdëmtimit në formën e riparimit ose të një vlere monetare.
2. Koordinatori Teknik dhe personeli përgjegjës teknik/metodik do të marrë të gjithë masat e duhura për eliminimin e ndonjë defekti që mund të ketë ndodhur gjatë orëve të mësimit dhe atyre të mbasdites.
3. Në ndërrimin e shërbimeve para dite me mbasdite, do të ketë një proces verbal mbi dorëzimin e palestrës, ku do të përfshihen të gjithë elementët e domosdoshëm që përbëjnë një kusht të dëmtimit serioz dhe përgjegjësi, për mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e veprimtarive sportive, për të tretët ose më gjerë.

4. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në palestër, Koordinatorin dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij, deri në mos funksionim (pajisjeve përkatëse etj).
5. Proces verbal do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

NENI 9 PALESTRA E GJIMNASTIKËS

Palestra e gjimnastikës është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmeri të programit akademik mësimor të gjimnastikës. Palestra do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i administratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati i UST-së.

9.1 PROCESI MËSIMOR

1. **Palestra e gjimnastikës** do të vihet në përdorim të procesit mësimor sipas orarit të përcaktuar akademik.
2. Në rast se konstatohen shkelje të orareve të paracaktuara, ato do të raportohen në dekanatet përkatëse.
3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mban përgjegjësi për sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
4. Staf i ndihmës mësimor mban përgjegjësi për vënien në dispozicion të mjeteve përkatëse për zhvillimin e procesit mësimor sipas orarit përkatës

9.2 ORARET

1. **Palestra e gjimnastikës** do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 23.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 . (Kohëzgjatja e seancave stërvitore të ekipeve sportive të gjimnastikës të kontraktuara, të jetë jo më e vogël se 90 minuta për fëmijë të rinj/a dhe 180 minuta e më shumë për të rritur/a. Kjo për arsye të kërkesave specifike që kanë disiplinat e gjimnastikës gariste (kompetitive) në kohëzgjatjen e seancave stërvitore me gjimnastët).
2. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e palestrës.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të zhveshjes.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve për vajza e djem.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të pedagogëve, të studentëve etj.
3. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Mirëmbajtjen e administrimit e veglave të shumëgarëshit gjimnastikor e të bazës materiale didaktike (mësimore), si dhe të pajisjeve të tjera sportive.
 - Sistemimin e funksionimit e bazës materiale didaktike (mësimore) lëvizëse, e cila do të shërbejë për realizimin e programit mësimor nga ana e pedagogëve.

- Mirëmbajtjen teknike profesionale të palestrës e veglave të shumëgarëshit gjimnastikor e të bazës materiale didaktike, të gatshme në çdo moment për mirëfunktionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.
- Në Palestrën e gjimnastikës do të funksionojë një koordinator metodik e teknik për komunikimin me pedagogët që kanë orë zhvillimi të mësimit dhe orë të veçanta specifike, para dite ose mbasdite.
- Për procesin mësimor do të jetë staf ndihmës akademik në mbështetjë te procesit mësimor dhe të bazës materiale .
- Për pasditë për të ndjekur kontratat me të tretë do të jetë një specialist nga administrata.

9.3 ETIKA DHE HYRJA

1. Në **Palestra e gjimnastikës** do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimit vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me papuçe ose çorape të përshtatshme për disiplinat e gjimnastikës.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në palestër.
4. Ndalohet rreptësisht përdorimi i ushtrimeve të nxemjes në trajtën e futbollit të vogël në palestër.
5. Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e palestrës.
6. Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
7. Ndalohet rreptësisht përdorimi nga studentët i mjeteve audio-vizive, si celular, kamera, mikroaparate filmimi etj. të këtij lloji gjatë zhvillimit të orës së mësimit pa lejen e pedagogut përkatës.
8. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat përkatëse të gjimnastikës, të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndërmjetme të mësimit para dite.

9.4 DËMTIMET DHE DEFEKTET

1. Të gjitha llojet e dëmtimeve që do të bëhen nga ana e studentëve, para, gjatë dhe mbas orës së mësimit do të kenë karakterin e çdëmtimit në formën e riparimit ose të një vlere monetare.
2. Koordinatori Teknik dhe personeli përgjegjës teknik/metodik do të marrë të gjithë masat e duhura për eliminimin e ndonjë defekti që mund të ketë ndodhur gjatë orëve të mësimit dhe atyre të mbasdites.
3. Në ndërrimin e shërbimeve para dite me mbasdite, do të ketë një proces verbal mbi dorëzimin e palestrës, ku do të përfshihen të gjithë elementët e domosdoshëm që përbëjnë një kusht dhe përgjegjësi të dëmtimit serioz, për mirëmbajtjen e mirëfunktionimin e veprimtarive sportive, për të tretët ose më gjerë.
4. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në palestër, Koordinatorin dhe personelin përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij, deri në mos funksionim (të pajisjeve përkatëse etj).
5. Proces verbalin do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

NENI 10 PALESTRA E SPORTEVE TË RËNDA

Palestra e Sporteve të Rënda është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmeri të programit akademik mësimor të gjimnastikës. Palestra do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i administratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati i UST-së.

10.1 PROCESI MËSIMOR

1. **Palestra e Sporteve të Rënda** do të vihet në përdorim të procesit mësimor sipas orarit të përcaktuar akademik.
2. Në rast se konstatohen shkelje të orareve të paracaktuara, ato do të raportohen në dekanatet përkatëse.
3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mban përgjegjësi për sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
4. Staf i ndihmës mësimor mban përgjegjësi për vënien në dispozicion të mjeteve përkatëse për zhvillimin e procesit mësimor sipas orarit përkatës

10.2 ORARET

1. **Palestra e Sporteve të Rënda** do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 23.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 .

2. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e palestrës.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të zhveshjes.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve për vajza e djem.
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të pedagogëve, të studentëve etj.

3. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:

- Mirëmbajtjen e administrimit e bazës didaktike mësimore, si pajisjeve sportive.
- Sistemimin e funksionimin e bazës didaktike mësimore lëvizëse, e cila do të shërbejë për realizimin e programit mësimor nga ana e pedagogëve.
- Mirëmbajtjen teknike profesionale të palestrës, e gatshme në çdo moment për mirëfunksionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.
- Në Palestrën e sporteve të rënda do të funksionojë një koordinator metodik e teknik për komunikimin me pedagogët që kanë orë zhvillimi të mësimi dhe orë të veçanta specifike, para dite ose mbasdite.
Për procesin mësimor do të jetë staf ndihmës akademik në mbështetje të procesit mësimor dhe të bazës materiale .
Për pasditë për të ndjekur kontratat me të tretë do të jetë një specialist nga administrata

10.3 ETIKA DHE HYRJA

1. Në **Palestrën e Sporteve të Rënda** do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimi vetëm në prani të pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me këpucë atlete ose me papuçe apo çorape të përshtatshme për disiplinat përkatëse.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në palestër.
4. Ndalohet rreptësisht përdorimi i ushtrimeve të nxemjes në trajtën e futbollit të vogël në palestër.
5. Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e palestrës.
6. Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
7. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat sportive përkatëse të lojrave me dorë, të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndërmjetme të mësimi para dite.

10.4 DËMTIMET DHE DEFJEKTET

1. Të gjitha llojet e dëmtimeve që do të bëhen nga ana e studentëve, para, gjatë dhe pas orës së mësimi, do të kenë karakterin e çdëmtimit në formën e riparimit ose të një vlere monetare.
2. Koordinatori Teknik dhe personeli përgjegjës teknik/metodik do të marrë të gjithë masat e duhura për eliminimin e ndonjë defekti që mund të ketë ndodhur gjatë orëve të mësimi dhe atyre të mbasdites.
3. Në ndërrimin e shërbimeve paradite me mbasdite, do të ketë një proces verbal mbi dorëzimin e palestrës, ku do të përfshihen të gjithë elementët e domosdoshëm që përbëjnë një kusht të dëmtimit serioz dhe përgjegjësi, për mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e veprimtarive sportive, për të tretët ose më gjerë.
4. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në palestër, Koordinatori dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij, deri në mos funksionim (pajisjeve përkatëse etj).
5. Proces verbal do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

NENI 11 SALLA E DANCIT

SALLA E DANCIT është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmeri të programit akademik mësimor të aerobisë dhe të dansit. Palestra do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i administratës së Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati i UST-së.

11.1 PROCESI MËSIMOR

1. **SALLAT E DANSIT** do të vihet në përdorim të procesit mësimor sipas orarit të përcaktuar akademik.
2. Në rast se konstatohen shkelje të orareve të paracaktuara, ato do të raportohen në dekanatet përkatëse.
3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mban përgjegjësi për sigurimin e mjeteve dhe kushteve optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

11.2 ORARET

1. SALLA E DANSIT do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 22.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 .
2. Në palestër do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e sallës.
3. Në sallë do të jetë personeli përgjegjës për:
 - Mirëmbajtjen e administrimit e bazës didaktike mësimore, si dhe pajisjeve sportive.
 - Sistemimin e funksionimit e bazës didaktike mësimore lëvizëse, e cila do të shërbejë për realizimin e programit mësimor nga ana e pedagogëve.
 - Mirëmbajtjen teknike profesionale të palestrës, e gatshme në çdo moment për mirëfunksionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.
4. Në sallën e dansit do të funksionojë një koordinator metodik e teknik për komunikimin me pedagogët që kanë orë zhvillimi të mësimi dhe orë të veçanta specifike, para dite ose mbasdite.
 - Për procesin mësimor do të jetë staf ndihmës akademik në mbështetjën e procesit mësimor dhe të bazës materiale .
 - Për pasditë për të ndjekur kontratat me të tretë do të jetë një specialist nga administrata

11.3 ETIKA DHE HYRJA

1. Në **Sallën e Dansit** do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimi vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes, me këpucë atlete ose me papuçe apo çorape të përshtatshme për disiplinat përkatëse.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në sallë.
4. Ndalohet hyrja e studentëve të tjerë, të cilët kanë pushim në kohën që zhvillohet mësimi i planifikuar për pedagogun.
5. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në disiplinat sportive përkatëse të lojrave me dorë, të cilët kërkojnë të argëtohen në oraret e ndermjetme të mësimi para dite.

11.4 DËMTIMET DHE DEFEKTET

1. Të gjitha llojet e dëmtimeve që do të bëhen nga ana e studentëve, para gjatë dhe mbas orës së mësimi do të kenë karakterin e çdëmtimit në formën e riparimit ose të një vlere monetare.

2. Koordinator Teknik dhe personeli përgjegjës teknik/metodik do të marrë të gjithë masat e duhura për eliminimin e ndonjë defekti që mund të ketë ndodhur gjatë orëve të mësimit dhe atyre të mbasdites.
3. Në ndërrimin e shërbimeve para dite me mbasdite, do të ketë një proces verbal mbi dorëzimin e palestrës, ku do të përfshihen të gjithë elementët e domosdoshëm që përbëjnë një kusht të dëmtimit serioz dhe përgjegjësi, për mirëmbajtjen e mirëfunktionimin e veprimtarive sportive, për të tretët ose më gjerë.
4. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në sallë, Koordinatori dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij, deri në mos funksionim (pajisjeve përkatëse etj).
5. Proces verbali do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

NENI 12

FUSHA E MINIFUTBOLLIT (KALCETO)

Fusha e mini-futbollit është një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo do të shërbejë për realizimin me efektshmëri të programit të lojrave sportive kolektive, siç është futboli i vogël.

Fusha e minifutbollit do të menaxhohet e mirëmbahet nga një personel i caktuar i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të UST, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit dhe Bordi i Administrimit.

12.1 QËLLIMI

1. Të shërbejë për realizimin e mësimit dhe edukimin e studentëve para dite e mbasdite, në vlerat argëtuese sportive.
2. Të plotësojë të gjithë kërkesat e masës së studentëve për shfrytëzimin e fushës për realizimin e mangësive metodike e teknike të programit mësimor që zhvillohet para dite.
3. Të realizojë të gjithë kërkesat që bëhen nga masa e studentëve dhe pedagogëve, në interes të një edukimi dhe argëtimi sportiv mbasdite.
4. Të shërbejë në plotësimin e gjithë kërkesave të palëve të treta për shfrytëzimin e fushës në oraret dhe hapësirat e saj.
5. Të shërbejë si mbështetje ligjore, financiare dhe organizative për funksionimin e institucionit dhe organizatave sportive, publike e private.

12.2 ADMINISTRIMI DHE ORARI

1. Fusha e minifutbollit do të funksionojë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 22.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00 .
2. Në fushën e minifutbollit do të jetë personeli përgjegjës për :
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e fushës.
 - Pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave të zhveshjes.

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve për vajza e djem.
3. Në fushën e minifutbollit do të jetë personeli përgjegjës për:
- Mirëmbajtjen e administrimin e bazës didaktike sportive.
 - Sistemimin e funksionimin e bazës didaktike sportive.
 - Mirëmbajtjen teknike profesionale të fushës e gatshme në çdo moment për mirëfunksionimin e saj në gjithë elementët e domosdoshëm.

12.3 HYRJA DHE ORARET

1. Në fushën e minifutbollit do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimi vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes me këpucë atlete.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në fushën e minifutbollit.
4. Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e fushës së minifutbollit.
5. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve, në perputhje me kërkesat e tyre argëtuese jashtë orareve të mësimi të planifikuar.

12.4 KONTRATAT

1. E drejta e shfrytëzimit të mjedisit sportiv i takon Administratorit të tij.
2. Marrëdhëniet ndërmjet Administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale.

12.5 DËMTIMET DHE DEFJEKTET

1. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në fushën e minifutbollit, koordinatori dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij deri në mos funksionim (p.sh. çarje e rrjetës, shkëputja e saj nga lidhjet, dëmtimi i tapetit të barit, dëmtimi i prozhektorëve ndriçues etj.
2. Proces verbali do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

12.6 TARIFAT

1. Fushat do të përdoren falas për studentët e universiteti mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë drejtuar dekanit të fakultetit ku do të jenë përcaktuar qartë përveç gjeneraliteteve të studentit/studentëve edhe orari, ditët dhe kohëzgjatja.
2. Fushat do të përdoren falas për stafin akademik dhe administrativ të universitetit mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë ku do të jenë përcaktuar qartë orari, ditët dhe kohëzgjatja.

3. Masa e pagesës për dhenien në shërbim të të tretëve të fushave llogaritet sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin në fuqi të Bordit të Administrimit të UST-së.

NENI 13 FUSHA E TENISIT

Fushat e Tenisit janë një mjedis arsimor sportiv nën juridiksionin e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ato do të shërbejnë për realizimin me efektshmëri të programit të lojrave sportive individuale dhe dyshe. Fushat e Tenisit do të menaxhohen e mirëmbahen nga një personel i caktuar i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të UST, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë të drejtave dhe detyrave të miratuara nga Rektorati, Senati i Universitetit, Bordi i Administrimit.

13.1 DITËT DHE ORARET

Fushat e tenisit do të funksionojnë nga dita e hënë deri në ditën e premte me orar të përcaktuar 08.00 – 22.00 ndërsa ditën e shtunë dhe të dielë me orar të përcaktuar 09.00 – 22.00.

13.2 MIRËMBAJTJA E FUSHAVE

Në fushat e Tenisit do të jetë personeli përgjegjës për :

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e fushave.
- Mirëmbajtjen e administrimit e bazës didaktike sportive.
- Sistemimin e funksionimin e bazës didaktike sportive.

HYRJA

1. Në fushat e Tenisit do të lejohet hyrja e studentëve për zhvillimin e orës së mësimet vetëm në prezencë të pedagogut përkatës.
2. Të gjithë studentët do të kenë këpucë civile dhe do t'i ndërrojnë ato në dhomat e zhveshjes me këpucë atlete të përshtatshme për disiplinën përkatëse.
3. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në fushat e tenisit.
4. Ndalohet rreptësisht pështytja në mjediset e fushave të tenisit.
5. Shoqata Studentore do të hartojë grupet e studentëve në përputhje me kërkesat e tyre argëtuese jashtë orareve të mësimet të planifikuar.

13.3 DËMTIMET DHE DEFEKTET

1. Në të gjitha rastet që do të ketë një dëmtim serioz në fushat e tenisit, koordinatori dhe personeli përgjegjës teknik profesional, do të mbajnë një proces verbal aktual/ditor për llojin e dëmtimit dhe procedura e ardhjes së tij deri në mos funksionim (p.sh. çarje e rrjetës, shkëputja e saj nga lidhjet, dëmtimi i tapetit, dëmtimi i prozhektorëve ndriçues etj).
2. Proces verbali do të firmoset nga të dy palët bashkërenduese dhe do t'i dërgohet brenda ditës Sektorit të shërbimeve dhe mirëmbajtjes, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse e më tej një relacion info për Administratorin.

13.4 PRENOTIMET DHE REZERVIMET

1. Fushat e Tenisit do të rezervohen ose prenotohen nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Ky prenotim ose rezervim do bëhet 1 ditë përpara, për personat që luajnë vetëm një ditë, bëhet pagesa në bankë.
3. Fushat e Tenisit do të kenë rezervime ose prenotime 1 vjeçare, 6 mujore, 3 mujore dhe 1 mujore, të cilat kanë me vehte dhe preferencën e orarit të zgjedhur, në ndryshim me stinët dhe orën e vitit.

13.5 TARIFAT

1. Fushat do të përdoren falas për studentët e universiteti mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë drejtuar dekanit të fakultetit ku do të jenë përcaktuar qartë përveç gjeneraliteteve të studentit/studentëve edhe orari, ditët dhe kohëzgjatja.
2. Fushat do të përdoren falas për stafin akademik dhe administrativ të universitetit mbas miratimit të grafikut, sipas një kërkesë ku do të jenë përcaktuar qartë orari, ditët dhe kohëzgjatja.
3. Fushat do të përdoren falas për persona vip – në raste të veçanta me miratim.
4. Masa e pagesës për shërbime ndaj të tretëve është sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin në fuqi të Bordit të Administrimit të UST-së.

NENI 14

Në vijim të kërkesave përkatëse për secilin ambient sporti, duke patur parasysh dhe grafikun përkatës pas procesit mësimor kontratat lidhet midis Administratorit dhe përfaqësuesit të shoqatës /institucionit/shoqërisë/ përfaqësuesit të grupit amator.

Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes përgatit dhe ndjek kontratat e shërbimeve me të tretë.

Raporton pranë administratorit për realizimin e procesit dhe problematikat të ndryshme që dalin gjatë realizimit të kontratës .

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit lëshon faturat përkatëse sipas kontratës dhe legjislacionit në fuqi .

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit rakordojnë në fund të çdo muaji realizimin e pagesës dhe ndjekjen e debitorëve.

Në përfundim të çdo muaji të dy Drejtoritë përcjellin raportin përkatës pranë Administratorit.

NENI 15

DISPOZITA TE FUNDIT

Kjo rregullore mund të përmirësohet dhe korrigohet në përputhje me zhvillimet e reja, ndryshimet në infrastrukturë që bën institucioni, si dhe me vendimet e ndryshme që merr Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e miratimit nga Senati Akademik i UST-së.

KRYETARI I SENATIT

PROF.DR. AGRON KASA

